



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTËR I SHTETIT PËR
MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

Buletini Mujor

Gusht 2022

NIS PROCESI I ZBATIMIT TË PROJEKTEVE FITUESE PËR STARTUP DHE LEHTËSUES STARTUP-ESH

Ekosistemi i startup-eve drejt formësimit, një model që do të na shoqërojë për një të ardhme drejt teknologjikes dhe digjitales.



MONITORIMI RIGOROZ NDAJ FONDIT DHE MBËSHTETJES PËRGJATË GJITHË FAZËS SË ZHVILLIMIT TË PROJEKTEVE

Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes ka sqaruar në detaje mënyrën e disbursimit të kësteve për zbatimin me sa më shumë sukses të granteve të shpallura fituese në thirrjen e parë për Startup dhe Lehtësues të startup-eve. Duke qenë se janë fonde buxhetore, afati për të përmbyshur aktivitetet e projekt-propozimeve dhe zbatimi i tyre përfundon brenda këtij viti. VKM nr. 25/2022 ka parashikuar që startup-et e të tre kategorive, por edhe inkubatorët, akseleratorët dhe organizuesit e eventeve mund ta aplikojnë deri në tre këste, duke paraqitur faturat dhe dokumentacionin përkatës. Përgjatë kategorisë lehtësues për startup-e bën sektori publik - bashki, universitete dhe shkolla - i cili për arsye të mos-planifikimit në buxhetin vjetor, fondet do t'iu kalohen në total. Monitorimi do të jetë i njëjtë si për sektorin publik, ashtu edhe për sektorin privat.



MBËSHTETJA DHE PROMOVIMI I IDEVE INOVATORE TË TË RINJVE

Si një prej problematikave sociale, fenomeni i migrimit dhe emigrimit ka nxitur sot entet publike si bashkitë dhe universitetet që t'iu krijojnë mundësi të rinjve për të zhvilluar idetë e tyre për të qëndruar në Shqipëri. Në fokus është nxitja e aftësive sipërmarrëse dhe shndërrimi i tyre në burim të ardhurash, shkëmbimi i njohurive, ideve dhe përvojës mes biznesit, si dhe nxitja e kreativitetit dhe shpirtit inovativ tek të rinjtë, të cilët do t'iu shërbejnë të ardhmes së ekonomisë në vend.

Krijimi i qendrave multifunktionale si inkubatorë për të rinjtë, u jep mundësi të ndërhyjnë në sektorë të ndryshëm dhe prioritarë. Ndërkohë, shumë të rinj të talentuar do të ofrojnë aplikacione që do të japin zgjidhje të shpejtë dhe digjitale për mbajtjen e shpenzimeve të biznesit, aktiviteteve dhe hapësirave të pashfrytëzuara duke eliminuar burokracitë, nëpërmjet një klikimi.

Një hapësirë e gjerë mes teknologjisë dhe digjitales do t'iu ofrohet mijëra të rinjve në vend nëpërmjet inkubatorëve dhe akseleratorëve. Këto të fundit, përtej formimit do të ofrojnë mundësi e mbështetje edhe për ide novatore, promovimin e tyre dhe daljen në treg. Startup-et dhe lehtësuesit e startup-eve do të promovohen edhe falë një plani të mirëfilltë komunikimi të mbështetur nga MiSHMS.

Muaji gusht ka shënuar fillimin e zbatimit të projekteve fituese të granteve të startup-eve dhe lehtësuesve të shpallura nga thirrja e parë për mbështetje financiare për ekosistemin e startup-eve. Pranë Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes janë zhvilluar takime të njëpasnjëshme me përfaqësuesit e fituesve të thirrjes së parë për grante duke përfunduar me sukses fazën e parë, atë të nënshkrimit të marrëveshjeve dhe nisjes së procesit të zbatimit të projektit.

Gjatë thirrjes së parë të hapur nga Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes u shpallën 23 startup-e, ndërkohë në kategorinë lehtësues u shpallën fitues: 7 bashki, 4 universitete, 1 shkollë e mesme profesionale, 15 inkubatorë/akseleratorë, si dhe 2 organizues eventesh. Kategoritë dominuese në këtë thirrje të parë ishin: TIK, Fintech, Robotika, Prodhimi, Transporti, Inxhinieria dhe Kultura. 45% e fituesve në kategorinë startup janë gra dhe vajza, ndërkohë mbi 50% e fituesve janë nën moshën 30 vjeç.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTËR I SHTETIT PËR
MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

Buletini Mujor

Gusht 2022

UPLIFT 2022
INFO SESSION
E MARTË, ORA 13:30

REGJISTROHU DHE BASHKOHU ME NE NË ZOOM

Uplift.al është akseleratori i parë evropian i startup-eve themeluar në Shqipëri, si një prej perspektivave më premtuese për startup-et inovative të Ballkanit Perëndimor që operojnë në vend nga kompania ICTS Media. Npërmjet programit “QENDRO”, Uplift.al synon në edicionin e radhës ngritjen e vlerës dhe përsheptimin e suksesit të startup-eve inovative, me një program intensiv 3-mujor.

Bëhuni pjesë e kësaj eksperience unike

16 – 17 – 18 SHTATOR </SHKODËR>

regist now

“Good Startup School” është një mundësi e re e të mësuarit se si të mendoni, punoni dhe ndërtoni një startup përmes formateve ndërkombëtare. Npërmjet “Thechstars Startup Weekend”, si një program thëllësisht teknik dhe intensiv ku npërmjet mentorëve, investitorëve dhe sponsorëve, angazhohen për të informuar se si ndërtohen dhe zhvillohet e vihet në jetë një biznes fitimprurës.

FUQIZIM I TË RINJVE NË BOTËN TEKNOLOGJIKE DHE DIGJITALE NËPËRMJET STARTUP-EVE. NIS ZBATIMI I PROJEKTEVE NË KATEGORINË LEHTËSUES

Ndërsa kategoria startup është kryesisht në fazën e studimit të prototipeve, kategoria lehtësues startup-esh ka hapur dyert për aplikime në fuqizimin e të rinjve që janë jo vetëm të apasionuar pas botës së teknologjisë dhe asaj digjitale, por çdo gjë që përbën inovacion. Inkubatorë dhe akseleratorë të ndryshëm të shpallur fitues kanë nxitur pjesëmarrjen e të rinjve në projektet e tyre, të cilët kalojnë përtej Shqipërisë, në rajon dhe botë.

Ndërkohë, paralel me punën e nisur nga fituesit e startup-eve dhe lehtësuesit e startup-eve, po punohet me shumë kujdes edhe për promovimin e prototipeve dhe punës së inkubatorëve dhe akseleratorëve në vend. Shumë shpejt, në Top Channel dhe në New Media Digital dhe Business Mag Albania, do të vijë si kurrë më parë e trajtuar më kujdes dhe si pararojë e promovimit të sipërmarrjeve inovatore.

WE GROW
WOMEN IDEAS

POWERED BY: GENORA, NISHTINA, ALBANIA

QËLLIMI YNE

PËRFAQËSIMI I SA MË SHUMË VAJZAVE DHE GRAVE NË EKOSISTEMIN E STARTUP-EVE.

MENTORIMI DHE TRAJNIMI I KËTYRE STARTUP-E DUKË NIXTUR RITIJEN PROFESIONALE PAVARËSINE EKONOMIKE SI DHE PUNËSIMIN.

KRIJIMI I NJË RRJETI TË TË QËNDRUESHËM TË GRAVE SIPËRMARRËSE.

Programi i akselerimit “WE Grow”, dedikuar ideve inovatore të grave dhe vajzave, synon krijimin e një rrjeti të grave sipërmarrëse që mbështesin dhe krijojnë mundësi të reja, si dhe përfaqësimin e sa më shumë prej tyre në ekosistemin e startup-eve. Çfarë e bën unik programim, është inkubimi i startupeve të themeluara nga vajza ose gra pranë bizneseve tëkonsoliduara nga vajza ose gra të tjera.

ME BEYOND IDEA
MUND TË SHIKONI TË ARDHMEN

Projekti “BEYOND IDEA”, npërmjet programit të inkubimit për startup-e me fokus inovacionin, teknologjinë dhe zgjidhjet e gjelbra, synon të zhvillojë mëndësinë sipërmarrëse, inovacionin dhe sipërmarrjen kreative. Programi do të asistojë sipërmarrësit e rinj dhe ambiciozë që kanë një ide biznesi, ose një biznes në fazat e hershme, të cilën synojnë ta zgjerojnë dhe zhvillojnë më tej.

PËR HERË TË PARË NË SHQIPËRI, REALIZOHET NË VELIPOJË FESTIVALI I SKULPTURËS NË RËRË “LAS ART FESTIVAL”, I MBËSHTETUR NGA MINISTRI I SHTETIT PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES. MINISTRJA BILALI: AKTIVITET, MUNDËSI E MIRË PËR ZHVILLIMIN E MËTEJSHËM TË BIZNESIT



Si asnjëherë më parë, plazhi i Velipojës është kthyer në një galeri në natyrë duke iu ofruar artdashësve një përvojë të rrallë, si dhe një mundësi më shumë për biznesin lokal. Përtej atraksionit kulturor dhe npërmjet artit të tyre, skulptorë të ardhur nga e gjithë bota i njohën vizitorët me bukuritë e rralla natyrore që ofron bregdeti i Velipojës. Turistë të ardhur nga vende të ndryshme janë ndalur duke soditur punimet në rërë, por edhe duke shijuar plazhin që prej vitesh të tëra renditet ndër plazhet me të mira dhe me rërë shumë kurative. “Përveç asaj që natyra i ka dhuruar, Velipojës tashmë i shtohet edhe një element tjetër, kultura!” – tha Ministrja Bilali në natën finale, ku fitues i edicionit të parë të këtij festivali u shpall artisti nga Kroacia, Nikola Faller, me mozaikun unik të realizuar në rërën pranë grykëderdhjes së Bunës. Festivali i parë i skulpturës në rërë “Land & Sand Art Festival” u zhvillua përgjatë datave 24-27 gusht 2022, në plazhin e Velipojës nën kujdesin e Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes zj. Edona Bilali, dhe me mbështetjen financiare të Ministrisë së Kulturës. Iniciative të tilla do të vijojnë të mbështeten nga Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes si lokomotiva të zhvillimit të ekonomik në zonat ku realizohen.